



Fuqizimi përmes Drejtësisë, Lirisë dhe Sinqeritetit!

Përsëndetje!

Mirëseardhje ndaj partnerëve, donatorëve, kolegëve dhe miqve tanë që po lexojnë këtë Newsletter të parë të përgatitur nga Mary Ward Loreto.

Jemi të lumtur të prezantojmë ngjarjet dhe lajmet e muajve të fundit. Shpresojmë se kjo mënyrë komunikimi do të sjellë më shumë partnerë në rrjetin tonë. Përmes shpërndarjes së lajmeve rreth projekteve dhe partneriteteve tona, do të zgjerojmë shtrirjen tonë dhe do të arrijmë një reagim më të madh prej atyre që punojnë në të njëjtën fushë si Mary Ward Loreto.

Në fokus të misionit tonë është lufta kundër trafikimit të qenieve njerëzore, një formë moderne e skllavërisë. Papa Francesku thërret se "Trafikimi i qenieve njerëzore është një plagë e hapur në trupin e shoqërisë bashkëkohore, një kanzhuk mbi trupin e Krishtit. Është një krim kundër njerëzimit." Ai thotë gjithashtu rreth këtij krimi se autoritetet ligjzbatuese, "janë përgjegjëse kryesisht për luftimin e këtij realiteti tragjik përmes zbatimit të fortë të ligjit" por gjithashtu "duke përfshirë punonjës social dhe humanitarë, detyra e të cilëve është t'u ofrojnë viktimave mirëpritje, ngrohtësi njerëzore dhe mundësinë e ndërtimit të një jete të re. Këto janë dy qasje të ndryshme por ato mund dhe duhet të kryhen së bashku". (Takimi me Drejtues Policie dhe Hierarkinë e Kishës, Romë 2014).

Mary Ward Loreto është pjesë e grupit të punonjësve përfaqë botës të cilët thirren të përgjigjen sipas mënyrës së dytë. Projektet dhe partneritetet tona me Të Ndryshëm dhe Të Barabartë, Ëngjëjt e vegjël, Projektin Roma, të menaxhuar nga SHKËJ dhe Besimtarë në Europë të Ndërlidhur Kundër Trafikimit dhe Shfrytëzimit (RENATE), janë një përpjekje për të punuar në fushat e kontaktit të drejtpërdrejtë me viktimat e trafikimit, në drejtim të parandalimit, ndërgjegjësisimit, advokimit dhe ndërrmarjes së fushatave në mbështetje të viktimave dhe çlirimit të botës prej këtij krimi të tmerrshëm.

Ne shpresojmë që ju do të ndiheni të frymëzuar të na bashkoheni më afër në këtë mision, teksha lexoni këtë Newsletter tonë të parë. Ju lutemi, ndiheni të lirë të bëni çfarëdo komenti mbi atë që këni lexuar, në faqen tonë në Facebook: Mary Ward Loreto, apo në faqen tonë të internetit www.albaniahope.com.

Faleminderit për interesin dhe mbështetjen tuaj të vazhduar.
Imelda Poole, Presidente e MWL.

Mary Ward Loreto



Fondacioni Mary Ward Loreto është një organizatë jo-fitimprurëse e cila ofron programe zhvillimi për komunitete vulnerabël në Shqipëri. Kjo organizatë ka si frymëzim të saj dhuntinë shpirtërore të Mary Ward, vlerat themelore të së cilës janë: LIRI, DREJTËSI dhe Sinqeritet.

Thelbi i kësaj dhuntie shpirtërore është përgjigja ndaj nevojave më të mëdha të botës së sotme, përmes edukimit dhe mjeteve të tjera. Organizata formon ortakëri dhe punon me 6 grupe kryesore: gra në rajone rurale dhe informale të Shqipërisë, viktimat e trafikimit, Fëmijë Romë dhe familjet e tyre, të burgosur nga 9 burgje në dioqezën Tiranë/Durrës, të rinj në qytetet kryesore dhe rajonet rurale dhe informale të Shqipërisë dhe në të ardhmen me burra nga rajone rurale dhe informale të Shqipërisë.

Vizioni ynë

Mary Ward Loreto merr jetë nga shpirti i Mary Ward, themelueses së Institutit të së Bekuarës Virgjëresha Mari. Vizioni ynë për Mary Ward Loreto është i një Fondacioni ku çdo person ka përjetuar të qenit i vlerësuar, çliruar dhe dashur si një individ i shenjtë. Kjo do të ndihmojë këdo që të rritet plotësisht në jetë dhe të fuqizohet si burra dhe gra kurajozë, të bëhen të gjallë ndaj nevojave të njerëzimit dhe të përkushtuar për krijimin e një bote më të mirë.

Mary Ward Loreto për Gratë

E Drejta e Grave në Shqipëri për Drejtësi, Liri dhe për ti dhënë zë të Vërtetës së tyre!

Çështje të grave në Shqipëri dhe probleme për ndryshim rrënjësor.

Çfarë do të thotë të jesh grua në Shqipëri?

Nëse do të lexonit pyetjen në sytë e një gruaje, do të thoshte shumë. Unë kam punuar për 10 vjet në zonat më problematike të Shqipërisë dhe kam takuar gra të rrahura të cilat kanë harruar të buzëqeshin, por ia dalin të mbijetojnë. Unë kam takuar gra të cilat rrisin fëmijët me shpirtin e një nëne plotë jetë, megjithëse nuk kanë jetuar kurrë. Unë kam takuar gra të cilat kërkojnë një dorë nga shteti por shteti nuk merr mundimin që ti shohë.

Kam lexuar ligjet mbi të drejtat e grave, të kopjuara fjalë për fjalë nga ligjet më të mira prej shteteve Nordike, ku gruaja është baza e çdo gjëje që ja vlen për t'u mbrojtur. Këtu, ligjet nuk zbatohen, sepse këtu jeta e një gruaje nuk llogaritet.



"Ka gra sa të duash" është një shprehje që e dëgjon shpesh. Në Shqipëri, shteti e konsideron gruan si një numër matematikor, qoftë relativ apo absolut, thjesht një numër.

Pavarësisht shumë sakrificave që bëjnë gratë sot, ata duhet të mbajnë barrën e paragjykitimit, diskriminimit dhe dhunës. Abuzimi i grave në Shqipëri është një problem kompleks dhe multidimensional, sepse përfshin forma të ndryshme që variojnë nga turpërimi, kërcënimet, izolimi shoqëror e deri tek marrdhëniet seksuale me dhunë dhe rrahja, sakrificë.

Megjithëse projekti po indentifikon rastet, dhe strukturat shtetërore kanë forcuar ligjin që lidhet me këtë fenomen, akoma kjo temë konsiderohet tabu, veçanërisht në komunitete rurale. Kjo e bën të vështirë për gratë që të denoncojnë dhunën. Atyre u mungon liria dhe u duhet të marrin leje për të dalë nga shtëpia.

Edhe kur bashkëshortët e tyre emigrojnë për qëllime ekonomike, grave u duhet të marrin leje prej bashkëshortëve të tyre në distancë. Ky boshllëk i vërtet informacioni dhe njohje të të drejtave të tyre si qenie njerëzore konfondohet me detyrimet e tyre sipas ligjeve kulturore.

Cilat janë rrënjët e këtij fakti? A është ky edukim patriarkalist? A është kjo një trashëgimi historike kulturore? Apo thjesht Shteti nuk do t'ia dijë. Sipas Ligjit Shqiptar, gruaja ka të njëjtat të drejta që ka një burrë, por a i gëzon ajo vërtet ato?

Sipas një raporti mbi çështjet gjinore të publikuar nga BBC, Shqipëria renditet në vendin e 108, afër me vendet Arabe, Nigerinë dhe Korenë e Veriut. Ne jemi i vetmi vend në Europë i cili është shënuar me shenjë ngjyrë portokalli, e cila tregon një përqindje të lartë pabarazie gjinore.

Gratë në këtë vend nuk kanë asgjë, përveç se ëndërra, dhe të ëndërrosh në kushte të tilla është një privilegj dhe sakrificë.

Kur qendra e mbështetjes për gratë bën mirë gjëra të zakonshme.

Fuqizimi, qëndrueshmëria, drejtësia sociale dhe barazia janë fjalë kyçe që po përdoren mjaft shpesh në ditët e sotme. Por kur vjen puna për t'u përballë me realitetin e ashpër e të jetuarit dhe të punuarit në Shqipëri, atëherë shihet hendeku i stërmadh mes fjalëve dhe veprave. Filozofia jonë tek MWL është që të **"kërkojmë për flori"** por me një strategji tjetër: **"duke i bërë mirë gjërat e zakonshme"** (Mary Ward 1585-1645).

Mary Ward Loreto sjell shpresë tek të gjithë ata me të cilët punon në Shqipëri. Mijëra jetë janë përmirësuar. Ne jemi krenarë që po mbështesim këtë punë të mrekullueshme.

Gjatë vitit të fundit, projekti i MWL i quajtur Mary Ward Loreto për Gratë, hapi 4 qendra për mbështetjen e grave të cilat jetojnë në zona rurale dhe më të margjinalizuara të Shqipërisë. Këto qendra janë të vendosura në zemër të komuniteteve: në Hot i Ri (Shkodër), Bajram Curri (Tropojë), Fier and Shendelli (Sarandë). Shërbimet mbështeten mbi etikën e Fondacionit dhe vlerat e Lirisë, Drejtësisë dhe Sinqeritetit.

Në qendër të vëmendjes është:

- Ofrimi i një mjedisi të sigurt emocional, psikologjik dhe fizik, i cili ushqen ndjesinë e fuqizimit.
- Dëgjimi, të kuptuarit dhe vleftësimi i grave në një atmosferë të sigurt, mbështetëse dhe jo paragjykuese.
- Inkurajimi i grave për të patur një zë përmes ofrimit të mundësisë, njohurisë dhe mbështetjes.
- Dhënia e mundësisë së barabartë grave për të arritur potencialin e tyre të plotë.
- Bashkëpunimi me organizata të tjera në mënyrë që të përmbushen nevojat e grave në komunitetet tona.
- Mbështetja e krijimit të bizneseve sociale dhe iniciativave sipërmarrëse.

Një qendër tjetër do të hapet së shpejti në Lezhë dhe një hulumtim do të kryhet në Tiranë për të vlerësuar nevojën për një qendër mbështetëse për gratë në këtë qytet. Ne po presim me entuziazëm rezultatet e këtij hulumtimi. Puna e përkushtuar e punonjësve kyç në këto qendra sjell një ndryshim pozitiv në jetët e grave të cilat janë në tranzicion, krizë apo në gjendje të dëshpëruar. Gratë i konsiderojnë këto qendra si një Oaz Shprese ku çdo grua ndihet e rëndësishme dhe e vlefshme. Ata nuk janë thjesht një numër në dosjen e çështjes apo një statistikë në census.



Jugu dhe Qendra e Shqipërisë

Mbjellja e Shpresës

Për tre muajt e fundit, fshati Jaru po vuan nga thatësira dhe mungesa e shiut. Një grua më tha së fundmi: "Ky vend është i mallkuar." Ishte hera e parë që dëgjoja një qëndrim të tillë nga një grua. Gjatë ditëve në vijim e dëgjoja këtë më shumë se 2-3 herë. Kur e dëgjoja për herë të katërt, mendova: A është vërtet i tillë?

Jaru është një fshat i vogël vetëm 10 km nga qyteti i Fierit, një nga përfaqësuesit e qendrave më të mëdha të jugut dhe vetëm 15 km nga Vlora- një qytet bregdetar dhe më i madhi në jug të Shqipërisë. Çfarë i shtyn gratë të mendojnë këto gjëra në një fshat kaq të vogël. A është fakti që në këto tre muaj natyra nuk është bujare dhe i lë ato të vuajnë?

Përse gratë nuk mendojnë si 20 vjet më parë kur ushqyen shpresa për një jetë më të mirë duke emigruar nga zonat e largëta të veriut të Shqipërisë për të ardhur në Jaru. Vetëm shpresa e madhe të bën të lëvizësh nga një pjesë e vendit në një tjetër.

Shpresa e tyre, në këto 20 vitet e fundit u godit nga zhgënjimi, qëndrimi larg i bashkëshortëve të tyre emigrantë, papunësia, vuajtjet, diskriminimi dhe frika. Shpresa u zvogëluar gjithmonë e më shumë por kurrë nuk u zhduk plotësisht. Çdo grua sjell tek Grupi i Grave të MWL një rreze shprese që i bën ato të zgjohen herët çdo ditë, të luftojnë, të mbijetojnë, duke punuar tokën dhe duke u kujdesur për fëmijët dhe pjesëtarët e tjerë të familjes. Ato madje mund të zgjohen me shpresë për shkak se mund të jenë njëra prej atyre me fat që kanë një vend pune në qytet.

Në takimet e zhvilluara në qendren e grave të MWL, grupi përpiqet për të mbledhur këto pjesë të shpresës dhe reflekton se si ata mund të rindërtojnë një shpresë të re duke bërë diçka të re dhe të ndryshme.

Gratë që punojnë në serën e luleve, ndryshe nga çdo grua tjetër e grupit janë shpresëdhënëse. Duke punuar me lule është diçka shumë e re për gratë, dhe ata janë angazhuar për të çuar këtë biznes përpara. Vetëm një vit ka kaluar që kur ata filluan të punojnë në serë, dhe gratë kanë hulumtuar tregun e luleve duke u përpjekur për të gjetur një vend në të. Ato janë përqendruar në 3 llojet e luleve në këtë fazë të biznesit. Varietetet e luleve në serë janë ende të ulëta në numër. Por këto lule kanë sjellë shpresë për gratë dhe kanë një ndikim të madh në perceptimin e tyre për të ardhmen.

Edhe pse jetojnë në Jaru mund të jetë mjaft sfiduese, unë mendoj se kjo zonë është e bekuar me njerëz të mirë dhe shpirtra të bukur që mund të gjejnë shpresë.



Një histori nga Qendra e Shqipërisë

Alba është një nënë e re 25 vjeçare me dy fëmijë të vegjël. Ajo është kujdestarja e vetme për nipin e saj. Askush nuk e di ku jeton Alba. Ajo u martua kur ishte 18 vjeç, kryesisht për arsye ekonomike pasi familja e saj ishte shumë e varfër. Për të gjetur një jetë më të mirë, ajo erdhi në Tiranë dhe jetoi në një shtëpi me qera. Në Tiranë u shfaqën shumë vështirësi pasi burri nuk gjeti punë të rregullt dhe kështu Alba punonte si pastruese. Të ardhurat nuk ishin të mjaftueshme për të mbajtur një familje prej pesë anëtarësh. Për shkak të stresit, burri i saj pati një zënkë me një person tjetër dhe për këtë përfundoi në burg për dy vjet. Alba mbeti e vetme me fëmijët dhe kishte shpenzime pafund.

E vetmja zgjidhje që mund të gjente ajo për problemet e saj në atë kohë ishte prostitucioni. Ajo u abuzua, frikësua, rrah, megjithatë ajo vazhdoi, duke qenë se ato ishin të vetmet të ardhura që mund të ushqenin fëmijët e saj. Por ajo nuk mund të vazhdonte edhe për shumë kohë. Ajo morri kurajon të fliste me motrën e saj dhe ajo e referoi atë tek ne. Alba dëshironte që të linte prostitucionin por dëshpërimisht kishte akoma nevojë për para për të siguruar gjërat më të domosdoshme. Ne ofruam një përgjigje urgjente e cila përfshinte një paketë ushqimore mujore, rroba për fëmijët dhe ndihmë mjekësore. Në të njëjtën kohë, u hartua bashkë më të një plan për të gjetur një punë të rregullt. U ofrua ndaj saj këshillim për të kapërcyer traumën nga abuzimi. Tani, pas dy vjetësh Alba është ribashkuar me bashkëshortin e saj dhe është e punësuar. Mbi të gjitha, ajo ndihet e lirë, e pavarur, plotë shpresë dhe e lumtur. (Emrat dhe vendet janë ndryshuar për të ruajtur konfidencialitetin).

Trashëgimi Kulturor: Butrinti

Pasi keni vizituar qytetin muzeal të Gjirokastrës, të ashtuquajturin "Qyteti i Gurtë" dhe arrini në qytetin portual modern të Sarandës, nuk mund të rezistoni pa vizituar destinacionin më magjik të udhëtimit tuaj, Parkun Kombëtar të Butrintit i cili ndodhet 20 kilometra nga Saranda.

Askush nuk mund ti shpëtojë magjepsjes, bukurisë dhe qetësisë së këtij vendi ku gardhet natyralë takojnë rrënoja të bukura antike. Qyteti i Butrintit është një prej fragmenteve të cilat formojnë cohën e panoramës së lashtë kulturore të Shqipërisë. Këtu, historia e ndërlidhur me artin antik dhe e rrethuar nga një hijeshi e mrekullueshme Mesdhetare, zë një vend të rëndësishëm në kujtesën e shumë njerëzve. Kulturat dhe traditat e besimit janë të puthitura në një vend, përgjatë historisë dhe kohës.

Tregu në Butrint

Me iniciativë të Fondacionit Butrinti në vitin 2007, një treg i vogël është vendosur në mes të bimësisë së dendur të parkut. Kjo mundësi ka motivuar një grup grash nga rajoni i Mirditës, të cilat, jo para shumë vitesh, kanë migruar nga veriu në një fshat të vogël afër Butrintit. Ato po furnizojnë tregun me produktet e tyre artizanale kulturore. Këto gra të fuqishme që luftojnë për jetën, kanë braktisur shtëpitë e tyre në Mirditë në 90' dhe kanë filluar një jetë të re në fshatin Shendelli, në periferi të Parkut të Butrintit.

Me ndihmën e Motrave Marchelino, përgjatë viteve, ato tani kanë elektricitet, një kopësht për fëmijë dhe një kishë për lutje. Këto gra të forta prodhojnë shumë punime artizanale për tregun në Butrint, kanë ndjekur një kurs gatimi dhe rrobaqepsie dhe po fillojnë të marrin përgjegjësi për jetën e tyre.



Veriu i Shqipërisë

Fuqizimi i Grave

Fuqizimi i grave lidhet ngushtësisht me zhvillimin ekonomik. Grupet e grave janë inkurajuar që të shfrytëzojnë aftësitë dhe dhuntitë e tyre. Këto konsistojnë kryesisht në punime artizanale me dorë të mësuara kur ato ishin fëmijë, si një mënyrë për të bërë rroba dhe zbukurime për shtëpinë, dhe jo si një mundësi biznesi. Mungesa e kulturës së punës dhe vështirësitë për marrjen e përgjegjësive të reja kanë qenë dy nga sfidat më të mëdha. Gratë kishin nevojë të madhe për trajnim për fuqizim njëzëz dhe mbështetje emocionale.



25 gra nga grupi i Hotit të Ri janë trajnuar dhe mbikëqyrur nga Animatori Social i MWL për Gratë për të bërë karta të qëndisura. Një grup kyç prej 10 grash takohen rregullisht në qendrën e MWL për Gratë dhe punojnë në grup. Pjesa tjetër e grupit takohen rrallë por u jepen udhëzime për punën dhe marrin materialet për qëndisjen e kartave në shtëpitë e tyre.

Ato përgatisin grupe të ndryshme skicash me qëllim që të përmbushin kërkesat e tregut. Për të punuar në mënyrë etike, tiparet e përzgjedhura nga interneti prej kompanive si Form-a-lines janë blerë. Animatori social i cili është një artist, pikturon karta me skica të reja të cilat përmbajnë përshëndetje të ndryshme si skica tradicionale, kartolina ditëlindje dhe karta për fëmijë. Vetë gratë janë inkurajuar gjithashtu që të përgatisin skica të reja. Shumë gra në fshat shfaqën një interes për t'u trajnuar dhe t'u bërë pjesë e grupit.

Vizitorët e Fondacionit MWL kanë vizituar grupin e Hotit të Ri dhe janë njohur me veprimtaritë dhe produktet e grupeve të MWL për Gratë. Hillary Cashman, dhe Motër Anna Hawke CJ panë mundësitë e shitjes së kartave në Mbretërinë e Bashkuar, në komunitetet e kishave, shkolla dhe panairë. Për këtë qëllim, grupi dërgon vazhdimisht kuti me karta.

Gratë e Tropojës:

Projekti i Mary Ward Loreto për Gratë në Tropojë vepron në tre zona: Raja, Dushaj dhe Cernicë. Këto zona numërojnë një total prej 90 grash, pjesëmarrja e të cilave varion sipas veprimtarisë. Dinamikat e këtyre grupeve janë të ndryshme, ashtu siç janë interesat, perceptimet, dhe situatat në të cilat ato gjejnë veten e tyre.

Pikat e forta të grave si një grup, janë:

1. Një aftësi për t'u përshtatur dhe funksionuar si një grup.
2. Një dëshirë për pjesëmarrje aktive dhe përfshirje në punë.
3. Të qenit e hapur.

Këto gra janë të forta dhe të gatshme për të ndryshuar dhe të fuqizohen për hir të familjes dhe vetes së tyre.

Shpjegim i Situatës së Ujit dhe Kulturës Vendase.

Problemi i ujit për vaditje:

Në një prej zonave rurale (Cernicë), banorët kanë vuajtur nga mungesa në zonë e ujit për vaditje e cila pengon progresin e tyre për zhvillimin e tokës për agrikulturë. Kjo ndikon mbi standardet e jetesës së tyre pasi nuk ka asnjë të ardhur nga toka.

Punonjësi social i MWL për Gratë e paraqiti këtë çështje tek autoritetet kombëtare dhe ndërmorri një sërë takimesh me kryetarin e bashkisë. Një projekt është përgatitur tashmë nga bashkia për të adresuar problemin e ujit për vaditje, megjithëse progresi ka qenë i kufizuar për shkak të mungesës së financimit nga shteti, që do të thotë se projekti mbetet ende në letër.

Një progres i vogël është bërë megjithatë me hapjen e kanalit nga banorët (e filluar nga një kandidat për kryetar bashkie përpara zgjedhjeve të 21 Qershorit). Ndërkaq, me ndarjen e re territoriale dhe stabilizimin e qeverisjes lokale, punonjësi social i MWL për Gratë do të ri-dërgojë këtë çështje tek bashkia e re.

PËRSE një Iniciativë Agrikulturore ?

Grave në Kallmet, në qarkun e Lezhës, u mungon arsimi dhe aftësitë për të gjetur punë. Më së shumti, ato janë të afta në agrikulturë dhe bagëti. Duke iu referuar këshillës së një specialisti vendas për agrikulturën, i mundësuar nga komuna për projektin, gratë pranuan që të mbjellin fasule të Kallmetit. Ky produkt mban emrin e fshatit. Synimi i iniciativës ishte të promovonte kultivimin e produkteve të zonës të cilat i referohen fshatit në kontekstin historik dhe agrikulturore. Kjo iniciativë ka qenë një sukses i madh dhe të gjitha groshët janë shitur në treg. Tani, gratë kanë vendosur të zhvillojnë këtë iniciativë me një prodhim tjetër fasulesh.



Kampi GLOW (Vajzat që Drejtojnë Botën Tonë)

Kampi Glow ishte një iniciativë e ndërmarrë në bashkëpunim me shërbimin e Vullnetarëve të Peace Corps në Lezhë. Falë disa takimeve dhe diskutimeve, një takim i mrekullueshëm u organizua sipas nevojave të vajzave në këto zona rurale. Qëllimi i Kampit Glow nuk ishte vetëm përfshirja e vajzave të reja, por garantimi se përfshirja e tyre do të ishte kuptimplotë. Kampi synoi në ndërtimin e vetë-vlerësimit tek vajzat, për t'i ndihmuar ato që të vlerësojnë veten e tyre, aftësitë dhe gjithçka që ato janë të afta të bëjnë. Përmes veprimtarive dhe lojrave, projekti i Mary Ward Loreto për Gratë synoi rritjen e ndërgjegjësimit tek vajzat e reja mbi faktin se ato sot janë drejtuese të vogla dhe se duke mësuar se cilat janë të drejtat e tyre dhe sa të vlefshme janë ato për komunitetin, vajzat do të mësojnë se nesër do të bëhen drejtueset e ardhshme të shoqërisë.



Mary Ward Loreto për të Rinjtë

Mary Ward Loreto për të Rinjtë (Projekti Rinor MWL)

Projekti për të Rinjtë i Fondacionit MWL synon të arrijë prosperitetin e të rinjve përmes edukimit dhe ka si qëllim kryesor fuqizimin e të rinjve për të vepruar me të gjitha kapacitetet në komunitetet e tyre, të jenë të punësuar, të gëzojnë liritë e tyre qytetare si dhe të promovojnë ndryshimin në Shqipëri.



Ky projekt filloi me një hulumtim me mbi një mijë të rinj dhe aktorë relevantë, të pasuar nga prezantimi i tij në Tiranë për pjesëtarë nga ministria e rinisë, qeveria dhe shumë persona të tjerë të interesuar. Ky hulumtim bëri që menaxheri i projektit të shkonte në rreth 20 rajone të Shqipërisë për të intervistuar mbi 1000 të rinj, aktorë relevantë dhe shumë drejtues të tjerë të OJQ-ve.



Puna u krye përmes intervistave individuale me të rinj si dhe organizimit të grupeve të fokusuara. Profesoresha në universitet, Marina Ndrio ishte udhëheqëse dhe autore e këtij hulumtimi.



Konferenca e Mary Ward Loreto për të Rinjtë

Një konferencë u mbajt në Hotel Tirana International për prezantimin e këtij hulumtimi si dhe çështjeve dhe nevojave të të rinjve në Shqipëri. Këto janë përcaktuar gjatë hulumtimit si rezultat i shumë orëve të dëgjimit dhe analizës së kujdeshme të gjetjeve në të cilat u identifikuan nevojat dhe problematikat. Më poshtë është korniza e programit të kësaj konference inovative në të cilën të rinjtë morrën pjesë me muzikë, dramë dhe poezi. Pyetjet dhe diskutimet që lindën në këtë konferencë frymëzuan gjithë ditën dhe çuan në hartimin e një plan veprimi dinamik.

Prezantimi i studimit “Nevojat dhe Problematikat e të Rinjve në Shqipëri”

Regjistrimi dhe mirëpritja e pjesëmarrësve

Fjala e mirëseardhjes

Presidentja e Fondacionit MWL
Fjalim i autoritetit Qeveritar
Performanca e të rinjve
(skeçe të shkurtra)

Koordinatori Rinor MWL

Prezantimi i Hulumtimit

Dr. Marina Ndrio
Diskutim në tryezë të rrumbullakët
Panel me Pyetje dhe Përgjigje: Të gjithë
pjesëmarrësit

Përmbledhje e Konferencës

Fjalim i Autoritetit Qeveritar

Shkelzen Marku

Përfundime

Këngë dhe poezi

Koktejt

Të gjithë pjesëmarrësit



Implementimi i Aksionit

Plani i veprimit u shkrua dhe menjëherë pas lançimit të projektit në eventin e organizuar tek Hotel Tirana International, u formuan tre grupe prej 15 të rinjsh në 3 qytete (Lushnjë, Tiranë dhe Pukë). Qëllimi i parë ishte të njiheshin dëshirat individuale dhe nevojat e të rinjve në lidhje me trajnimin profesional dhe punën, duke ndërtuar një marrëdhënie të mbështetur në besim. Ky synim u arrit përmes takimeve në grup, seanceve personale të cilat kanë çuar në zhvillimin e një portofoli për çdo person të ri. Në shtator do të fillojë trajnimi profesional dhe hyrja në shërbimin në komunitet.

Një tjetër aspekt i projektit janë trajnimet në 10 rajone të tjera të Shqipërisë mbi tema të cilat u konsideruan si më të rëndësishmet nga të rinjtë pjesëmarrës në hulumtim. Këtu përfshihen Fuqizimi Njerëzor dhe njohja e identitetit personal (vetë ndërgjegjësimi), zgjidhja e konflikteve dhe trajnimet për rritjen e ndërgjegjësimit kundër trafikimit në 10 shkolla vendore nga dhjetë rajone.

Vizita e Greta në Shqipëri

Menaxheri i MWL për të Rinjtë ishte i pranishëm dhe përfaqësoi fondacionin MWL në takimin e GRETA në Shqipëri (Grupi i Ekspertëve të Këshillit të Europës në Veprim kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore). Ky takim u organizua me përfaqësues të Shoqërisë Civile Shqiptare me qëllim mbledhjen e informacionit për raportin e ri të Këshillit të Europës mbi situatën e Trafikimit të Qenieve Njerëzore në vendin tonë. GRETA përgatiti një raport katër vjet më parë dhe ata duan të vlerësojnë nëse ka ndonjë përmirësim të situatës. (parandalimi identifikimi i viktimave, ndihma ndaj viktimave, kompensimi i viktimave, fëmijët viktimë, etj.). Menaxheri i MWL për të Rinjtë foli rreth punës së Fondacionit MWL në fushën kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore dhe punës në partneritet me OJQ-të shqiptare (Të Ndryshëm dhe të Barabartë) dhe ato Britanike (Medaille Trust) dhe lidhjen tonë me RENATE. Ekspertëve të pranishëm iu dhanë raporte dhe prezantime nga MWL të cilat mund të ishin të dobishme për ndërtimin e draft-raportit të tyre mbi mënyrën se si po zbatohet Konventa Anti-Trafik e përgatitur nga Shqipëria.

Logjistika e Mary Ward Loreto

Logjistika në Mary Ward Loreto është një sektor i cili mbështet projektet dhe Fondacionin Mary Ward Loreto për realizimin e projekteve të tij. Përbëhet nga një ekip prej tre punonjësish: një Menaxher Logjistik (Pjetër Tanushaj), një shofer (Edmond Kocli) dhe një sanitare dhe kuzhinierë (Majlinda Zajmi).

Ky ekip siguron që personeli dhe çdo material i nevojshëm për realizimin e çdo veprimtarie është në vendin dhe kohën e duhur. Ekipi (veçanërisht Menaxheri Logjistik) bën blerjet e materialeve të nevojshme dhe marrëveshjet me palët e treta nëse është nevojë për rezervimin e ambienteve për veprimtari jashtë mjediseve të Mary Ward Loreto. Këto rezervime mund të jenë për vende si hotele, kur stafi janë në udhëtim apo dhoma Konferencash apo ambiente për eventet e Mary Ward Loreto.

Menaxheri Logjistik kujdeset për vizitorë të cilët vijnë në Mary Ward Loreto. Ai i shoqëron ata në vendet e takimit dhe udhëton me ta sipas agjendës së tyre. Ai kujdeset për akomodimin dhe gjithë nevojat e tyre. Menaxheri Logjistik është përgjegjës për gjatjen e ambienteve të reja për zyra të Mary Ward Loreto kur është e nevojshme dhe i pajis ato sipas nevojave. Ai është gjithashtu përgjegjës për çdo material të blerë në Fondacionin Mary Ward Loreto dhe bën çdo vit një inventar të azhurnuar. Ai është përgjegjës për blerjen dhe mirëmbajtjen e automjeteve të Fondacionit Mary Ward Loreto.

Ne aplikuar tek MIVA për një makinë dhe ata pranuan aplikimin tonë për të dytën herë. Makina e parë na u dha disa vite më parë për Projektin e Mary Ward Loreto për Gratë, dhe këtë vit ata na mbështetën për të blerë një makinë tjetër për MWL/Projektin e MWL për të Rinjtë. Falë tyre, ne tani kemi dy makina të mundësuar për Fondacionin tonë nga OneMenMIVA. Makina e fundit u ble nga Menaxheri Logjistik në Gjermani. Ai udhëtoi dhe kontrolloi të gjitha sallonet e makinave në mënyrë që të gjente makinën më të mirë sipas nevojave të MWL dhe brenda buxhetit.



Projekti i Mary Ward Loreto, URAT: Projekt për rritjen e Ndërgjegjësimit Kundër Trafikimit në Shqipëri.

Që prej 2014, Projekti i ri i MWL, URAT, ka organizuar më shumë se dyzetë seminare trajnuese për rritjen e ndërgjegjësimit mbi trafikimin e qenieve njerëzore për më shumë se 1020 persona. Projekti, i cili menaxhohet dhe financohet nga organizata jo-qeveritare Mary Ward Loreto në Shqipëri, është një bashkëpunim midis disa organizatave të pranishme në Shqipëri, si p.sh, Peace Corps, Të Ndryshëm dhe Të Barabartë, IRCA (Instituti i Kulturës Rome në Shqipëri dhe në Dobi të Gruas Shqiptare. Rrjeti URAT, i përbërë nga besimtarë dhe bashkëpunëtorë të angazhuar kundër trafikimit në Shqipëri, i qëndroi mjaft afër këtij projekti dhe shërbeu si bord këshillimi gjatë kësaj kohe. Projekti u fokusua kryesisht mbi ata persona të cilët janë më vulnerabël dhe të marginalizuar shoqërisht dhe ekonomikisht në Shqipëri, të cilët kanë nevojë për mbrojtje kundër formave të ndryshme të shfrytëzimit, përfshirë trafikimin e qenieve njerëzore. Raporti Përfundimtar i Projektit Urat: Shih nën titullin: "Trafikimi i Personave" në faqen në internet www.albaniahope.com



Fondacioni Tony Blair Faith



Gjatë javës së fundit të muajit shkurt 2015, Imelda ka qenë e ftuar për të dhënë leksion në dy seminare të zhvilluara në internet ('webinar') për Fondacionin Tony Blair Faith. Kjo ishte hera e tretë në Shqipëri që ajo ftohej të bënte këtë. Për dy ditë ajo udhëhoqi dy seminare online me 6 shkolla. Tema ishte 'Trafikimi i Qenieve Njerëzore: Problematika dhe Parandalimi.' Seminari i parë përfshiu Irlandën e Veriut dhe dy shkolla në Meksikë. Seminari i dytë përfshiu shkolla në Indi,

Indonezi, Jordani dhe Pakistan. Në të dy seminare online, sesioni zgjati dy orë. Studentët ishin shumë mirë të përgatitur dhe paraqitën pyetje të mirë menduara dhe me kalimin e kohës u zhytën gjithmonë e më thellë brenda temës. Çështjet kryesore të cilat paraqesnin shqetësim lidheshin me mungesën e vullnetit në shoqëri për të luftuar këtë krim të tmerrshëm si dhe mungesën e një qasje të koordinuar globale. Pyetjet u vërtitën gjithashtu rreth çështjeve që lidhen me internetin dhe deep net. Pjesëmarrësit e rinj ishin mjaft mendjemprehtë dhe drejtuan diskutimin.

Lidhjet e MWL me Qeverinë Shqiptare

Ne kemi inkurajuar, veçanërisht gjatë vitit të fundit, punën për një ndryshim të përgjithshëm në Shqipëri. Kjo shihet si një nga sfidat më të rëndësishme të hasura në luftë kundër skllavërisë së ditëve moderne të trafikimit të njerëzve. Njerëz vulnerabël janë objektivi kryesor i trafikantëve. Është puna jonë që të çlirojmë njerëzit nga zinxhirët e varfërisë e cila çon në mjerim. Puna për një ndryshim sistemik ka bërë që MWL të formojë një grup akademik i cili bëri fillimisht një hulumtim pilot për theksimin e korrupsionit dhe etikës së dobët në sistemin arsimor. Çështjet që lidhen me varfërinë dhe papunësinë e lartë të të rinjve në Shqipëri kanë çuar në kryerjen e një hulumtimi efikas dhe informues për rrugën tonë përpara me projektin për të Rinjtë (MWL Youth) si dhe ka qenë proces për projektin e Mary Ward Loreto për Gratë. Të gjitha këto iniciativa e kanë sjellë Fondacionin MWL më afër me departamentet e qeverisë të cilat kanë dhënë mbështetjen e tyre dhe kanë qenë të pranishme në eventet në të cilat janë prezantuar temat e hulumtimit dhe kanë paraqitur të vërtetën.



Nora Malaj nga Ministria e Arsimit, Elona Gjebrea nga Ministria e Punëve të Brendshme, me portofolin e anti-trafikimit dhe Anuela Ristani si përfaqësuese e Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, kanë qenë të pranishme në evente të ndryshme dhe kanë mbështetur hapur iniciativat. MWL përfaqësohet në koalicionin qeveritar kundër trafikimit si dhe platformën kundër trafikimit të Shoqërisë Civile të BE-së. Elona Gjebrea ka folur në tre prej eventeve tona, të cilat kanë përfshirë gjithashtu takimin e Bordit të RENATE në Shqipëri këtë vit, i cili u menaxhua nga MWL në aspektin logjistik.



UCESM:

Takimi në Shqipëri i Unionit të Drejtuesve Kryesorë Fetarë në Europë, Mars 2015

Më 26 Mars, Imelda ishte e ftuar që të përfaqësonte RENATE në AGM të UCESM, Konferenca e Drejtuesve Kryesorë Fetarë në Europë. 30 shoqata europiane përfaqësoheshin nga rreth 70 murgj. Imelda u prit ngrohtësisht dhe mori reagime pozitive pas prezantimit të saj.



Një prej fryteve të shkëlqyer të këtij prezantimi ka qenë diskutimi që vazhdon ende me një prift dhe murg nga Ukraina të cilët po kërkonin ndihmë për fillimin e punës anti-trafik në vendin e tyre. Kjo bisedë vazhdon akoma, dhe tani dy prej anëtarëve të RENATE nga Sllovakia do të shkojnë në Ukrainë në vjeshtë për të takuar priftërinj dhe murgj, dhe të shohin për mundësitë përpara në këtë punë sfiduese.

Gjithashtu qysh prej atij takimi, një murgeshë e pranishme në takim ka dhuruar nga kongregacioni i saj 5000 euro për punën e RENATE. Jemi shumë mirënjohës për këtë. Ditën pasuese, disa prej stafit të MWL erdhën në pelegrinazh në Shkodër me 50 anëtarë të UCESM. Drejt fundit të Kreshmes ne vizituam pjesën më të madhe të ndalesave të ndryshme të kryqit duke ndjekur kështu gjurmët e shumë martirëve, priftërinjve dhe murgeshave të cilët vdiqën gjatë regjimit komunist në Shqipëri, për besimin e tyre. Ne e mbyllëm ditën me Meshë tek Katedralja në Shkodër.

Vizitorë/Rrjete Medaille Trust

Një bashkëpunim i rëndësishëm ka qenë me Medaille Trust në Mbretërinë e Bashkuar. Zhvillimi i punës me gratë e Shendelli dhe puna efikase së bashku përtej kufijve ka qenë e paçmueshme. Ky partneritet ka bërë që stafi i Medaille Trust të vijnë në Shqipëri për të parë punën që po bëhet dhe për të hyrë në dialog të mbarë rreth kësaj. E njëjta gjë ka ndodhur në disa raste kur stafi i MWL kanë shkuar në Mbretërinë e Bashkuar për të vizituar strehat dhe për të zhvilluar praktikë të mirë përmes punës me viktimat Shqiptare të trafikimit të cilat po qëndrojnë në strehat në Mbretërinë e Bashkuar. Një qasje e përbashkët ndodhi edhe në Slloveni ku stafi nga D&E, MWL dhe Medaille Trust u takuan me anëtarë të policisë për të zhvilluar mënyra bashkëpunimi më efektive ndërmjet kufijve.



Vizitorë të tjerë

MWL po pret vazhdimisht vizitorë në Fondacion, duke zhvilluar rrjetet dhe forcuar punën përmes bashkëpunimit të mirë. Si vizitorë kanë qenë përfaqësues nga Policia, Profesorë nga Universiteti i Tiranës, Peace Corps, aktorë relevantë nga OJQ-të shqiptare, Priftërinj dhe murgj dhe ne falënderojmë Peshkopin George Frendo OP i cili ka mbështetur gjithmonë punën tonë dhe na viziton rregullisht.

Takimi i Bordit të RENATE u organizua nga MWL në Prill 2015, në Durrës, Shqipëri.

Stafi i MWL kanë shkëlqyer në çdo mënyrë, asnjë detaj nuk ka munguar gjatë përgatitjes. Kjo ishte një eksperiencë e pasur për anëtarët e Bordit si dhe për stafin e MWL. Delegatët e vlerësuan kuptimin e thellë të situatës lokale në Shqipëri sipas përshkrimit të folësve të ftuar Ep. George Frendo OP; Fr. Giovanni Peragine; Znj. Edlira Gjoni; Znj. Elona Gjebrea dhe Znj. Marjana Meshi.

Secili prej tyre u ndal në aspekte të rëndësishme si më poshtë, sipas përgjegjësi të tyre individuale:

- Besimet dhe traditat e pasura fetare të Shqipërisë.
- Një përmbledhje e Konferencës së Besimtarëve në Shqipëri.
- Realiteti kulturor i Shqipërisë.
- Një përmbledhje e situatës së trafikimit të qenieve njerëzore në Shqipëri dhe politikat e Qeverisë në përpjekje për ta luftuar atë.
- Puna anti-trafik në nivelin bazë, në Shqipëri. Pjesa më interesante e javës ishin padyshim Udhëtimet në Terren për të dëshmuar drejtëpërdrejtë misionin anti-trafik në Shqipëri përmes projekteve të Mary Ward Loreto dhe atyre Rome; Projektit të të Ndryshëm dhe të Barabartë; dhe shpenzimi i kohës me pjesëtarë të grupit të grave në projektin e Shkodrës/Hot i Ri. Përmes këtyre projekteve, përmasat gjigande të sfidës për të luftuar trafikimin e qenieve njerëzore u zvogëluan në mundësi realiste, dhe shprehja "Jo më skllëvër por vëllezër dhe motra" u bë e gjallë.



Programi i Sponsorizimit në Universitet

Dy studentë shqiptarë janë sponsorizuar për të studiuar një program Master jashtë vendit, duke qenë se ky program ofrohej nga MWL i cili siguroi që aplikimi dhe përmbushja e kërkesave nga donatorët të realizoheshin me sukses. Jemi të kënaqur të pohojmë që sponsorizimi ynë i parë ka qenë një sukses shumë i madh. Brikena Petritaj fitoi me sukses një vend në Universitetin e Durham në Mbretërinë e Bashkuar dhe arriti një mirënjohje në Masterin e saj në TESOL. Ajo qëndroi me një ish nxënës të Loreto, Mançester, Dr Mary McHugh, e cila e mbështeti atë përgjatë vitit të studimeve. Ajo ishte një prej studentëve më të mirë të klasës së saj. Urime Brikena.




Sponsorizimi i dytë u përfitua nga Sara Çapaliku. Ajo po studion akoma në Bremen, Gjermani dhe do të marrë së shpejti kualifikimin e Masterit në studime Ndërkombëtare.

MWL është e lumtur të vazhdojë të mbështesë këtë program për të rinj të moshës 25 vjeç deri 30 vjeç. Kjo është një mundësi e mrekullueshme.



Ekspozita e Artit në MWL

Një projekt i ri dhe disi i ndryshëm u ndërmor në javën e dytë të Prillit, kur një grup psikologësh në Shqipëri kërkuan ndihmë për rritje fondesh për mbulimin e kostove të pagesave të tyre për studimin e Psikologjisë Njohëse të Sjelljes. Ky është një kurs katër vjeçar dhe udhëhiqet nga një skuadër specialistësh nga Izraeli. Vendimi i parë që u mor për rritjen e këtyre fondeve ishte për të pikturuar 50 tablo. Tre pjesëtarë të grupit ishin artistë. MWL ofroi organizimin e ekspozitës. Një numër i vogël pikturash u shitën ndërsa të tjerat u shitën në Mbretërinë e Bashkuar përmes kontakteve atje. Një event pasoi në një prej hoteleve të mundësuar nga grupi Ndërkombëtar në Tiranë, në të cilën u shitën dy piktura të tjera. Imelda pati mundësinë të fliste në këtë event rreth misionit të MWL, kështu që kishte një përfitim shtesë për MWL. Deri më tani janë mbledhur mbi 2,000 euro, të mjaftueshme për depozitën e parë për tu dhënë prej secilit student. Urime psikologë! Më poshtë është një prej pikturave e cila është shitur:



Miqte e Mary Ward

Duke qenë se takimi i Miqve të Mary Ward këtë muaj do të jetë i fundit përpara pushimeve, disa pjesëtarë të grupit shkuan në pelegrinazh dhe në një tërheqje të vogël nga puna (retreat) në Kallmet, ku grupi mund të reflektonte në kishën e bukur Eufemia dhe zonën përreth. Tema e tërheqjes nga puna ishte 'Besimi në Zot'. Ne reflektuam mbi disa nga fazat e jetës së Mary Ward në të cilat ajo u sfidua më së shumti. Ne u lutëm së bashku, qëndruam në heshtje për meditim dhe ndamë me njëri tjetrin reflektimet tona pasi ishim zhytur në mendime rreth disa prej pikturave të Jetës së Pikturuar të Mary Ward. Ne reflektuam se si betejat e saj dhe besimi për ti kapërcyer ato, mund të zbatohen në jetët tona.



Pas një mëngjesi lutjeje, shkuam në një vend të bukur ku ishte zhvilluar një restorant organik. Vakti ishte i shijshëm. E mbyllëm ditën duke pirë kafe afër detit në Shëngjin. Gjatë kthimit për në shtëpi ishim një grup shumë i lumtur.

Faleminderit të Gjithëve!

Do të dëshironim të falënderonim donatorët tanë bujarë për mbështetjen e tyre e cila ka mundësuar Mary Ward Loreto të vënë në zbatim planin e tyre të veprimit gjatë vitit.

Në veçanti, falënderojmë donatorët tanë Europeanë, OneMenMiva, Anëtarët e Provincës Angleze të IBVM, Mary Ward International Spanjë, donatorët tanë të shumtë nga Mbretëria e Bashkuar, si individë ashtu edhe famulli, donatorë privatë në Australi dhe ShBA, Trustin Medaille dhe Shkollat Loreto, gjithashtu në Mbretërinë e Bashkuar. Këto janë donatorët tanë aktualë por duke qenë se ky është Newsletter ynë i parë, dëshirojmë të përfshijmë në falënderimet tona edhe ata të cilët kanë qenë donatorë për ne në të shkuarën. Kjo përfshin të gjithë njerëzit dhe grupet e mësipërme por gjithashtu, Mary Ward International Irlandë, Mary Ward International Australi, dhe Fondacionin për Besimtarë Conrad Hilton, ShBA. Do të dëshironim gjithashtu të falënderonim bashkëpunëtorët dhe vullnetarët tanë të cilët kanë punuar pa lodhje gjatë këtij viti në favorin tonë.

Gjithashtu, ne duam të falënderojmë ekipin e Fondacionit Mary Ward Loreto, të cilët kanë punuar në mënyrë të palodhshme për vënien në zbatim të qëllimeve dhe synimeve të projekteve në mënyra shumë frytdhënëse dhe krijuese. Pa ata, fuqizimi i shumë prej përfituesve nuk do të kishte qenë e mundur të arrihej.

Faleminderit përsëri në emër të Fondacionit Mary Ward Loreto, për mbështetjen dhe besimin tuaj të mirë. Pa mbështetjen tuaj të vazhduar, misioni i Fondacionit Mary Ward Loreto do të ishte i pamundur.

8 Shkurti, Dita e Shën Bakhita: Dita e Parë Ndërkombëtare e Lutjes kundër Trafikimit



Dita e Shën Bakhita u mbajt për herë të parë si një ditë ndërkombëtare lutjeje, të dielën më 8 Shkurt 2015. Imelda ishte ftuar të merrte pjesë në Romë në Deklaratën për Shtyp që lajmëronte këtë ditë lutjeje në 4 – 5 Shkurt. Përveç mbi 30 gazetarëve të pranishëm, ndër personat e pranishëm përfshiheshin edhe Sr Gabrielle, Drejtori i Talitha Kum dhe shumë persona të nderuar të kishës, duke përfshirë tre Kardinalë që përfaqësonin Drejtësinë dhe Paqen,

Migrantët, Refugjatët dhe UISG. Kjo ishte një mundësi për të folur kundër këtij krimi të tmerrshëm.

“Synimi parësor i Ditës Ndërkombëtare është formimi i ndërgjegjësimit më të madh mbi këtë fenomen dhe për të reflektuar mbi situatën e përgjithshme të dhunës dhe padrejtësisë që prekin shumë njerëz, të cilët nuk kanë zë, nuk llogariten, dhe janë askushi: ata janë thjesht skllëvër.” (Osservatorio Romano)

Në Shqipëri ne zgjodhëm të kishim një event në Katedralen në Tiranë, të cilën stafi i MWL e organizoi me URAT, rrjetin kundër trafikimit. Ne shfaqëm filmin e jetës së Shën Bakhita të pasuar nga një shërbesë lutjeje kundër trafikimit. Ishte një eksperiencë e thellë për këdo ndërsa kujtonim viktimat e trafikimit për qëllim të shfrytëzimit seksual, viktimat për punë, fëmijët viktimat dhe trafikimin e organeve. Çdo vit, ky do të jetë një event i rëndësishëm në kishë.



Faleminderit!